REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br. 69/17
Nr. i fq. / Br. st.
Data: / Datum 27.01.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

# PLANI I PUNËS PËR VITIN 2017

**Janar, 2017**

# Hyrje

Kryetari i komunës i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij që janë me interes për komunën dhe qytetarët, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, statutin e komunës, vendimet e kuvendit të komunës dhe aktet tjera nënligjore. Këto kompetenca dhe përgjegjësi realizohen po ashtu edhe në bazë të planit të tij të punës, i cili është dokument bazë për punën njëvjeçare, përkatësisht qeverisë komunale.

Hartimi i këtij plani është një reflektim i angazhimit të vazhdueshëm për t'i kanalizuar nismat për planifikim të objektivave, përkatësisht prioriteteve të cilat do të mund të realizohen bazuar në planifikimin buxhetor të v. 2017, për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët tanë.
Natyrisht se ka sfida gjatë përmbushjes së këtyre objektivave, por me një angazhim të përbashkët mund të arrihen rezultate të kënaqshme.

Ky Plan i punës paraqet prioritetet e Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2017 dhe jep përmbledhje të objektivave, aktiviteteve të planifikuara dhe realizimin e tyre. Po ashtu, përcakton edhe treguesit, si dhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara, por i cili përgjatë vitit 2017 do të mund të evoluojë.

**Prioritetet kryesore gjatë vitit 2017:**

- Menaxhimi efektiv dhe transparent i buxhetit të komunës, si dhe rritja e të hyrave vetanake të komunës;
- Angazhimet e vazhdueshme për realizmin e të hyrave të planifikuara buxhetore dhe shfrytëzimi sa më racional i mjeteve buxhetore, përkatësisht shpenzimeve buxhetore, si dhe raportimi i rregullt në kuvendin e komunës;
- Implementimi sipas planifikimit dhe me kohë i projekteve kapitale, si dhe angazhimi për shpenzim të mjeteve financiare të investimeve kapitale, sidomos mjeteve të grantit qeveritar;
- Ngritja e bashkëpunimit me organet e nivelit qendror sidomos me Qeverinë e Republikës se Kosovës në implementimin e projekteve, të cilat janë paraparë të financohen nga buxheti i Kosovës në veçanti projektet dy apo trivjeçare;
- Përcjellja e implementimit të kontratave për pronat në pronësi të komunës që janë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm (tokave dhe objekteve) me qëllim të krijimit të të hyrave buxhetore;
- Ndërmarrja e masave për lirimin e pronave komunale të uzurpuara;
- Angazhimet për gjetjen e donatorëve për investime në komunë e në veçanti në sektorin e bujqësisë;
- Angazhimet për themelimin e zonës së lirë ekonomike në fsh.Lumadh;
- Rritja e prodhimtarisë bujqësore, përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve, organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve profesionale për pfermer si dhe subvencionimi i tyre;
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes nga hidrosistemi „Ibër Lepenc";
- Angazhimet për gjetjen e donatorëve për investime në ndërtimin e kolektorit kryesor buzë lumit „Silnica" dhe impiantit për punimin e ujërave të zeza;
- Menaxhim më i mirë i mbeturinave duke marrë për bazë planin tani më të aprovuar për menaxhimin e mbeturinave;
- Ofrimi i shërbimeve sa më cilësorë ndaj qytetarëve;
- Gjithpërfshirja në arsim dhe ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
- Promovimi, përkatesisht avancimi i aktiviteteve kulturore atyre të rinisë dhe në lëmin e sportit;
- Përmirësimi i kushteve të jetesës së popullatës në zonat rurale përmes zhvillimit të infrastrukturës së ujësjellësit në pjesën perëndimore të komunës, rrjetit të kanalizimeve etj.;
- Ofrimi i mbështetjes së klubeve sportive, organizatave të dala nga lufta, organizatave rinore, OJQ –ve tjera të komunës, si dhe kategorive tjera në veçanti familjeve skamnore;
- Bashkëpunimi me organet e nivelit qendror veçanërisht me qeverinë dhe ministritë e linjes në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë në rastin e marrjes së vendimeve me rëndësi dhe interes për komunën dhe qytetarët;
- Bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi me KFOR-in, Policinë e Kosovës FSK-në në aspektin e sigurisë së përgjithshme;
- Bashkëpunimi me shoqërine civile dhe qytetarë në aspektin e krijimit të mundësive për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes në komunë;

Në vijim të do të paraqiten planifikimet s... fushave duke filluar nga:

**Ekonomi, bujqësi, pylltari**

__Objektivat:__ Zbatimi i strategjisë zhvillimore të komunës, tërheqja e investitorëve të brendshëm dhe të jashtëm me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës, rritja e prodhimtarisë bujqësore përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve veçmas perimekultura dhe blegtoria (degë në zhvillim), organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve profesionale, subvencionimit sa më të madh të fermerëve, shfrytëzimi sa më racional i pronave (tokave bujqësore) në pronësi të komunës përmes dhënies në shfrytëzim me qëllim të krijimit të të hyrave buxhetore, përmirësimi i klimës dhe mundësive për të bërit biznes, ndërgjegjësimi i qytetarëve, si dhe ruajtja e pyjeve.

Prioritetet:

1. Në Komunën e Vushtrrisë në çdo vit vërehet dukshëm një orientim i madh i fermerëve në ndërtim të serrave me qëllim të kultivimit të perimekulturave.Veçmas vërehet rritja e kultivimit të specave, domates dhe kornishonit (trangujve të vegjël). Ky investim në serra për fermerët tonë është një burim i mirë për një mirëqenie më të mirë familjare duke gjeneruar të hyra. Vlerësohet që investimet në projekte të tilla zbusin papunësinë, krijojnë të hyra për fermerët tonë dhe të gjithë qytetarët kanë mundësi të shërbehen me produkte kualitative, më të freskëta, por edhe me çmime më të lira për faktin se nuk i nënshtrohen importit. Këto aktivitete bujqësore rrisin numrin e të punësuarve të ekonomive familjare;
2. Realizimi i projektit për rregullim të bademeve (bankinës) është projekt kapital dhe afatgjatë. Rëndësia e këtij projekti qëndron në faktin që komuna në vitin 2011 ka filluar me projektin e parë në këtë drejtim dhe për synim kemi parandalimin e vërshimeve nga reshjet në tokat bujqësore. Gjatë viteve lumi „Silnica" si rezultat i reshjeve të mëdha në disa vende ka devijuar rrjedhën, ndërsa në shumë raste rrezikon vërshimet në toka me mbjellje të kulturave të ndryshme, veçmas patates. Investimet në këtë projekt kursejnë qindra-mijëra euro nga xhepat e fermerëve. Është projekt me kosto të lartë financiare, por mendohet që gradualisht në çdo vit të kemi mjete buxhetore të planifikuara për këtë projekt dhe të rregullohen të gjithë bedenat, me prioritet pikat më emergjente;
3. Mundësitë promovuese mbeten prioritet me rëndësi në kuadër të aktiviteteve tona. Në këtë drejtim dëshirojmë që të japim mundësi më shumë fermerëve me qëllim rritjen e tregut, bizneseve zgjerimin e kapaciteteve, njëkohësisht edhe komunës përmes pjesëmarrjes në panaire të ndryshme të tregojmë potencialet dhe mundësitë tona;
4. Pyjet në komunën tonë, ashtu si në gjithë territorin e Kosovës nuk janë në gjendje të mirë. Si rezultat i bartjes së kompetencave nga MBPZHR dhe me qëllim mbrojtjen dhe kujdesin ndaj pyjeve, llogarisim se na duhet të ndërmarrim hapa konkret në këtë drejtim përmes shqyrtimit të mundësisë së rritjes të nr.të rojeve të pyjeve nëse jo në formë të pranimit në kohë të pacaktuar, atëherë në formë të ashtuquajtur "marrëveshje për shërbime të veçanta".

Në vijim do të paraqiten në formë tabelare punët dhe aktivitetet, si dhe planifikimi i realizimit buxhetor

| Nr | Emri i projektit | Shuma-€ | Participojnë | | | Periudha kohore | Zhvillimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Komuna | Donatorët | Përfitu-esi | | |
| 1. | Zhvillimi i aktiviteteve në QKB | | | | | Gjithë vitin | Përpjekjet do të jenë për zvogëlimin dhe eliminimin e të gjitha barrierave për të bërë biznes dhe shkurtim të kohës për regjistrim të biznesit. |
| 2. | Përkrahja e bizneseve të reja dhe ekzistuese me pajisje | 88.000 | 40.000 (35.000-10, 5.000-21) | 48.000 HELP | | Mars – tetor 2017 | |
| 3. | Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave | 40.000 | 10.000<br>10 | 30.000<br>21 | | Qershor - shtator/2017 | Me këtë projekt synohet që të ndikohet në ruajtjen e tokave bujqësore, duke parandaluar dëmet nga vërshimet. |
| 4. | Makina për mbjellje të grurit | 20.000 | 5.000<br>10 | 15.000<br>21 | | Janar - tetor/2017 | Ky projekt mundëson fleksibilitet dhe kualitet në punën e fermerëve. |
| 5. | Perimekulturë | 30.000 | 25.000<br>10 | 5.000<br>21 | | Shkurt/2017 | Synohet që të zhvillohen investime në lëmin e ndërtimit të serrave. |
| 6. | Pemëtari | 50.000 | 30.000<br>10 | 20.000<br>21 | | Shtator/2017 | Zhvillimi i pemëtarisë veçmas në sipërfaqe të vogla (20-50 ari) është sfidë e cila do të zbatohet nëpërmes këtij investimi (qershi, mjedra, lajthi, etj) |
| 7. | Mbulimi i normave të interesit për biznese të reja | 100.000 | 100.000<br>10 | | | | Është risi dhe do të shohim se si dhe sa do të mund të realizohet ky projekt |
| 8. | Makina për mbjelljen e misrit | 30.000 | 15.000<br>10 | 5.000<br>21 | | | Rritja dhe forcimi i ekonimive familjare në sektor të bujqësisë |
| 9. | Makina sillazhi | 30.000 | 20.000<br>10 | 10.000<br>21 | | | Ky projekt synohet të realizohet me bashkëfinancim me fermerët. |
| 10. | Projektet në bashkëfinancim me donatorë (Bujqësi) | 40.000 | 20.000<br>10 | 40.000<br>21 | | | Është projekt mjaft i rëndësishëm dhe ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit. |
| 11. | Dita e patates | | | MBPZHR | | 1-10/tetor /2017 | Organizimi "Dita e patates" ka karakter të promovimit të kësaj kulture nga komuna jonë,fermerëve të vyeshëm. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | suksesve të kompanisë "Pestova", investimeve nga fermerët dhe kompania, si dhe paraqitjen e inovacioneve teknologjike për çdo vit. |
| 12. | Vaksinimi i qenve shtëpiakë | 3.000 | 3.000 | | | Qershor/ shtator-2017 | Vaksinimi bëhet në kuadër të përgjegjësive ligjore dhe me qëllim mbrojtjeje nga sëmundjet e ndryshme. |
| 13. | Mbjelljet pranverore/ vjeshtore | | | | | -Shkurt/prill -Shtator/nëntor /2017 | Drejtoria për EBZH do të përcjellë të gjitha mbjelljet dhe të mbajë të dhëna në kulturat bujqësore. |
| 14. | Korrje-shirjet | | | | | Korrik/gusht /2017 | Do të përcillet fushata e korrje-shirjeve përmes komisionit. |
| 15. | Takimi me fermerët më të dalluar të komunës dhe donatorët | | | -IADK , -Komuna | | 11/dhjetor /2017 | -Për këtë aktivitet synojmë të bëhet tradicional dhe është një rast i mirë që drejtoria për EBZH dhe kryetari i komunës të shpërblejë me mirënjohje fermerët e dalluar, ndërsa me falënderime donatorët që kanë kontribuar në mënyra të ndryshme. |
| 16. | Takimi me bizneset më të dalluara të komunës dhe donatorët | | | -Komuna, - Bizenese | | 11/dhjetor /2017 | -Ky aktivitet është bërë tradicional dhe është një rast i mirë që drejtoria për EBZH dhe kryetari i komunës të shpërblejë me mirënjohje bizneset e dalluara, ndërsa me falënderime donatorët që kanë kontribuar në mënyra të ndryshme. |
| 17. | Subvencionimi i kulturave lavërtare | | | MBPZHR | | Pranverë/ vjeshtë/2017 | Subvencionimi i grurit, misrit, sojës dhe lulediellit, bëhet në çdo vit. |
| 18. | Grantet në bujqësi | | | MBPZHR | | Pranverë/ verë/2017 | Thirrja për aplikim në grante në degët e bujqësisë tani po bëhet në çdo vit. |
| 19 | Pastrimi i pyjeve | | | | | Pranverë/ vjeshtë/2017 | Planifikohet që në vitin 2017 të bëhet pastrimi i pyjeve në Sllakoc dhe Vesekoc. |
| | **GJITHSEJ:** | **418.000 €** | | | | | |

**Buxheti dhe financat**

| Nr. | Drejtoria | Objektivat | Aktivitetet | Afati | Ecuri | Pjesëmarrësit tjerë | Ndërlidhja me |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 1.Përgatitjet fillestare për startimin e sistemit të pagesave (Free Balanc) për vitin fiskal 2017 | 1.Kompletimi i dokumentacionit për të gjitha programet buxhetore dhe monitorimi i tyre | Janar/2017 | | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive |
| 2 | | 2.Rregullimin e dokumentacionit për personat me autorizimet e veçanta: nëpunësi administrativ i pagesave, zyrtari autorizues, zyrtari aprovues, zotuesi dhe certifikuesi për periudhën 2017 | 2.Plotësimi i kërkesës për qasje të përdoruesve në SIMFK. | Janar/2017 | Sipas planit të rrjdhës të parasë së gatshme | | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive |
| 3 | | 3.Pasqyrat financiare për buxhet për vitin 2016 | 3.Plotësimi më efikas dhe dorëzimi i PVF | Janar/2017 | | | |
| 4 | | 4.Përgatitja e rrjedhës së parasë për të gjitha programet për vitin 2016 | 4.Plotësimi i formularëve të rrjedhës së parasë në bazë të planifikimit të buxhetit në MEF. | Janar/2017 | | | |
| 5 | | 5.Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2016 | 5.Implementimi i të hyrave të bartura në vitin 2017 | Shkurt-mars/2017 | | | |
| 6 | | 6.Përgatitja e listave për të hyra të paarkëtuara të taksës në firmë | 6.Evidentimi i të gjitha bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre | Shkurt/2017 | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | | 7.Përgatitjet e duhura për realizimin e projekteve të pakryera nga viti 2016 (projektet investuese) | 7.Kompletimi i dokumentacionit për zotimin e mjeteve | Shkurt-mars/2017 | | | |
| 8 | | 8.Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB | 8.Përmbajtja e afatit kohor në bazë të Udhëzimit administrativ 02/2010 | Çdo muaj/2017 | | | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive |
| 9 | | 9.Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake për tremujorin e parë | 9.Përgatitja e informatës lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave | Çdo tre muaj/2017 | | | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive |
| 10 | | 10.Prezantimi i Qarkores 01/2017 kufijve të parë buxhetor dhe përpunimi i buxhetit për vitin 2018 konform qarkoreve të marra nga MEF-i | 10.Të harmonizojë kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventual të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2017 | Maj-qershor 2017 | | | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive |
| 11 | | 12.Përgatitjet për rishikimin buxhetor (varësisht nga kërkesat e MEF-it) | 12.Përgatitja e formularëve lidhur me ndryshimet buxhetore | Qeshor-korrik/2017 | | | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive |
| 13 | | 13.Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për gjashtëmujorin e parë për vitin fiskal 2017 | 13.Raportimi i informatës lidhur me projektet e realizuara në bazë të planifikimit të buxhetit | Qershor/2017 | | | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | | 14.Informatë për realizimin e investime kapitale, realizimi i projekteve të parapara me planin dinamik të shpenzimeve. | 14.Përgatitja e informatës lidhur me shpenzimet buxhetore | 14 ...rik/2017 | | | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive |
| 15 | | 15.Shqyrtimi i Rregullores së tatimit në pronë për vitin 2018 | 15.Dorëzimi në MEF | 15 Korrik/2018 | | | |
| 16 | | 16.Përgatitja e treguesve final buxhetor për vitin 2018 konform qarkores nga MEF-i | 16.Evidentimi i të gjitha kërkesave të drejtorive për vitin fiskal 2018. | 16 Shtator/2017 | | | Të gjitha programet buxhetore të drejtorive |
| 17 | | 17.Përgatitjet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2017 | | 17 Dhjetor/2017 | | | Të gjitha programet buxhetore |

**Prokurimi Publik**

Planifikimi i prokurimeve sipas kategorive, punë, shërbime dhe furnizime për t'i përmbushur kërkesat, gjegjësisht planifikimet e të gjitha shtyllave buxhetore – njësive shpenzuese, si vijon:

KONTRATAT PËR FURNIZIM

| Nr. | Përshkrimi i furnizimeve | Vlera e parashikuar e kontratës | Zhvillimi i procedurave të prokurimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Furnizim me material zyrtar | 95.270,00 € | 2017 |
| 2 | Furnizimi me naftë dhe derivate të naftës | 145.317,00 € | 2017 |
| 3 | Furnizim me materiale të shtypura për zyrë | 7.000,00 | 2017 |
| 4 | Furnizimi me orendi për zyrë | 14.214,00 | 2017 |
| 5 | Furnizimi me pajisje tjera | 10.096,00 | 2017 |
| 6 | Furnizimi me pajisje për zërim | 10.000,00 | 2017 |
| 7 | Furnizimi me veshmbathje | 18.500,00 | 2017 |
| 8 | Furnizimi me ushqim dhe pije | 55.108,00 | 2017 |
| 9 | Furnizimi me material higjenik | 51.816,81 | 2017 |
| 10 | Furnizimi me butan gaz | 200,00 | 2017 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 11 | Furnizimi me teknologji informative dhe pajisje të teknologjisë informative | 36.850,00 | 2017 |
| 12 | Furnizimi me dru për ngrohje | 74.500,00 | 2017 |
| 13 | Furnizimi me thëngjill për ngrohje | 47.100,00 | 2017 |
| 14 | Furnizimi me aparate fotokopjuese | 7.350,00 | 2017 |
| 15 | Furnizimi me makinë për larjen e enëve | 3.000,00 | 2017 |
| 16 | Furnizimi me inventar për shkolla | 49.500,00 | 2017 |
| 17 | Furnizimi me inventar për objektin e ri të komunës | 50.000,00 | 2017 |
| 18 | Furnizimi me medikamente për QKMF | 52.300,00 | 2017 |
| 19 | Furnizimi me pajisje mjekësore | 9.327,00 | 2017 |
| 20 | Furnizim me inventar për QKMF | 8.000,00 | 2017 |
| 21 | Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve | 15.000,00 | 2017 |
| 22 | Furnizimi me automjete për bartjen e pacientëve për hemodializë | 36.000,00 | 2017 |
| 23 | Furnizimi me gypa për kanalizim për ujërat e zeza | 40.000,00 | 2017 |
| 24 | Furnizimi dhe vendosja e kamerave në qytet | 5.000,00 | 2017 |
| 25 | Furnizimi me libra për bibliotekë | 5.500,00 | 2017 |
| 26 | Furnizimi me inventar për shtëpinë e komunitetit | 5.000,00 | 2017 |
| 27 | Furnizimi me pajisje për matje gjeodezike | 16.000,00 | 2017 |
| 28 | Furnizimi me pajisje laboratorike për shkollat e mesme | 25.600,00 | 2017 |
| 29 | Furnizimi me makina për mbjelljen e misrit | 20.000,00 | 2017 |
| 30 | Furnizimi me pajisje për përkrahjen e bizneseve të reja | 40.000,00 | 2017 |
| 31 | Furnizimi me fidane mjedre, qershi, lajthi, fiua etj.) | 50.000,00 | 2017 |
| 32 | Furnizimi me makina për sillazh | 30.000,00 | 2017 |
| 33 | Furnizimi me makina për mbjellje të grurit | 20.000,00 | 2017 |
| | **Totali:** | **1.053.548,81** | |

KONTRATAT PËR SHËRBIME

| Nr. rendor i prokuri -meve | Përshkrimi i kontratës | Vlera e parashikuar e kontratës (€) | Zhvillimi i procedurave të prokurimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Servisimi i teknologjisë informative | 6.845,00 | **2017** |
| 2 | Botimet e reklamave dhe konkurseve | 8.900,00 | **2017** |
| 3 | Shërbimet e internetit | 3.970,00 | **2017** |
| 5 | Shërbime hoteliere | 31.902,00 | **2017** |
| 6 | Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve | 41.780,00 | **2017** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 7 | Shërbime tjera kontraktuese të k paskohëshme | 618.838,00 | **2017** |
| 8 | Mirëmbajtja e objekteve | 19.298,19 | **2017** |
| 9 | Shërbimet e udhëtimit jashtë vendit | 8.350,00 | **2017** |
| 10 | Shërbimet arsimore dhe trajnuese | 15.079,00 | **2017** |
| 11 | Shërbimet e ndryshme shëndetësore | 7.000,00 | **2017** |
| 12 | Regjistrimi dhe kontrolla teknike e automjeteve | 16.700,00 | **2017** |
| 13 | Hartimi i projekteve | 71.200,00 | **2017** |
| 14 | Pastrimi dhe larja e automjeteve | 1.600,00 | **2017** |
| 15 | Shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse | 1.800,00 | **2017** |
| 16 | Shërbimet e udhëtimit brenda vendit | 2.739,00 | **2017** |
| 17 | Mirërmbajtje e mobilieve dhe pajisjeve | 18.282,00 | **2017** |
| | | **874.283,19 €** | |

KONTRATAT PËR PUNË

| Nr. rendor i prokurimeve | Përshkrimi i kontratës | Vlera e parashikuar e kontratës (€) | Zhvillimi i procedurave të prokurimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Asfaltimi i rrugës "Ahmet Ademi" projekt dyvjeçar | 32.000,00 | **2017** |
| 2 | Asfaltimi i rrugës "Rrustem Mehmeti" | 5.000,00 | **2017** |
| 3 | Asfaltimi i rrugëve Stanoc i Epërm, Gracë | 120.000,00 | **2017** |
| 4 | Asfaltimi i rrugës "Epopeja e Galicës" në fshatin Galicë | 11.000,00 | **2017** |
| 5 | Asfaltimi i rrugës "Veli Osmani" në fshatin Dolak | 17.000,00 | **2017** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 6 | Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Bivolak projekt dyvjeçar | 38.000,00 | 2017 |
| 7 | Asfaltimi i rrugës "Rexhep Rzhana" në fshatin Sfaraçak | 20.000,00 | 2017 |
| 8 | Asfaltimi i rrugës "Emin Uka" në fshatin Banjskë | 20.000,00 | 2017 |
| 9 | Asfaltimi i rrugës "Rexhep Rrahmani" në fshatin Kollë | 15.000,00 | 2017 |
| 10 | Asfaltimi i rrugës "Paqja" në fshatin Maxhunaj | 11.500,00 | 2017 |
| 11 | Asfaltimi i rrugës "Jeton Tërstena" Segmenti i II | 14.000,00 | 2017 |
| 12 | Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Beçuk projekt dy vjeçar | 153.000,00 | 2017 |
| 13 | Asfaltimi i rrugës Stanic i Poshtëm - Lumadh -Prefluzhë | 80.000,00 | 2017 |
| 14 | Asfaltimi i rrugës "Qemajl Jashari" në fshatin Ashlan | 6.750,00 | 2017 |
| 15 | Asfaltimi i rrugës "Musa Surdulli" në fshatin Samadrexhë | 22.500,00 | 2017 |
| 16 | Asfaltimi i rrugës, lagjja „Islami'' në fshatin Taraxhë projekt dyvjeçar | 20.400,00 | 2017 |
| 17 | Asfaltimi i rrugës "Abedin Maxhuni" në fshatin Maxhunaj | 24.000,00 | 2017 |
| 18 | Asfaltimi i rrugës "Çlirimi" në fshatin Mihaliq projekt dyvjeçar | 17.200,00 | 2017 |
| 19 | Asfaltimi i rrugës "Martirë e Druarit" në fshatin Druar projekt dyvjeçar | 35.500,00 | 2017 |
| 20 | Asfaltimi i rrugës "Vëllezërit Veseli" | 14.016,00 | 2017 |
| 21 | Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Zhilivodë projekt dyvjeçar | 57.000,00 | 2017 |
| 22 | Asfaltimi i rrugës "Selmon Maloku" në fshatin Samadrexhë projekt dyvjeçar | 19.000,00 | 2017 |
| 23 | Asfaltimi i rrugës "Mulliri i Shpëtimit" në fshatin Ashlan | 5.000,00 | 2017 |
| 24 | Asfaltimi i rrugës "Rizah Mehana" në fshatin Akrashticë projekt dyvjeçar | 20.600,00 | 2017 |
| 25 | Asfaltimi i rrugës "Zylfije Krasniqi" | 10.560,00 | 2017 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 26 | Asfaltimi i rrugës "Hasan T[illegible] Shabani " në Vushtrri | 19.520,00 | **2017** |
| 27 | Asfaltimi i rrugës i rrugëve lokale në fshatrat Reznik, lagjet ,,Mustafa, Curri dhe Makiqi'', si dhe në fshatin Shalle lagjja projekt dyvjeçar | 65.000,00 | **2017** |
| 28 | Asfaltimi i rrugës "Sefer Mehana" në fshatin Akrashticë projekt dyvjeçar | 29.000,00 | **2017** |
| 29 | Asfaltimi i rrugës "Agim Drevinja" | 9.000,00 | **2017** |
| 30 | Ndërtimi i mureve mbrojtëse në fshatrat Bivolak, Stroc dhe Gllavatin | 15.000,00 | **2017** |
| 31 | Asfaltimi i rrugës "Hasan Bunjaku" në fshatin Nedakoc | 14.000,00 | **2017** |
| 32 | Bashkëfinancim me Ministrinë e Transportit | 100.000,00 | **2017** |
| 33 | Asfaltimi i rrugës "Dëshmorët e Druarit" projekt dyvjeçar | 32.300,00 | **2017** |
| 34 | Asfaltimi i rrugës "Sekine Maxhuni" | 73.600,00 | **2017** |
| 35 | Asfaltimi i rrugës "Zenun Avdulli" në fshatin Duboc | 18.500,00 | **2017** |
| 36 | Asfaltimi i rrugës "Nazmi Ispahiu" | 10.880,00 | **2017** |
| 37 | Asfaltimi i rrugës "Shefqet Isa" në fshatin Dumnicë | 11.000,00 | **2017** |
| 38 | Asfaltimi i rrugës "Hysen Hajrizi" në fshatin Balincë projekt dyvjeçar | 53.000,00 | **2017** |
| 39 | Ndërtimi i trotuarëve | 25.000,00 | **2017** |
| 40 | Ndërtimi i parqeve | 56.000,00 | **2017** |
| 41 | Ndërtimi i urave | 15.000,00 | **2017** |
| 42 | Riasfaltimi i rrugës Vushtri - Sllatinë | 20.000,00 | **2017** |
| 43 | Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara | 70.000,00 | **2017** |
| 44 | Ndërtimi i kanalizimeve | 265.612,00 | **2017** |
| 45 | Ndriçimi publik | 10.000,00 | **2017** |
| 46 | Rrënimi i objektit të komunës dhe rregullimi i oborrit | 40.000,00 | **2017** |
| 47 | Rrugët e rendit të katërt | 50.000,00 | **2017** |
| 48 | Rregullimi i varrezave | 15.000,00 | **2017** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 49 | Ndërtimi i rrugëve me kubëz betoni | 318.364,00 | 2017 |
| 50 | Projektet në bashkëfinancim me donatorë | 150.000,00 | 2017 |
| 51 | Ndërtimi i serrave | 30.000,00 | 2017 |
| 52 | Projektet me bashkëfinancim me donatorë - bujqësi | 40.000,00 | 2017 |
| 53 | Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave | 40.000,00 | 2017 |
| 54 | Renovimi i QMF-së në Lumadh | 15.000,00 | 2017 |
| 55 | Renovimi i shtëpisë rezidenciale | 18.800,00 | 2017 |
| 56 | Restaurimi i shtëpisë së Mahmut agë Gjinollit | 10.000,00 | 2017 |
| 57 | Rregullimi i kulmit të palestrës sportive | 8.000,00 | 2017 |
| 58 | Ngjyrosja e hapësirave publike | 7.000,00 | 2017 |
| 59 | Ndërtimi i lapidarëve | 30.000,00 | 2017 |
| 60 | Ndërtimi i qendrës së kulturës projekt trevjeçar | 990.000,00 | 2017 |
| 61 | Renovimi i objektit para komunës | 0,00 | 2017 |
| 62 | Ndërtimi i sheshevë në qytet | 90.000,00 | 2017 |
| 63 | Ndërtimi i shkollave fillore | 0,00 | 2017 |
| 64 | Ndërtimi i fushave sportive | 0,00 | 2017 |
| 65 | Renovimi / meremetimi i shkollave | 89.000,00 | 2017 |
| 66 | Rregullimi i platove në shkollat fillore në Druar, Pantinë dhe Maxhunaj | 55.000,00 | 2017 |
| 67 | Ndërtimi i rrethojave në shkolla | 14.500,00 | 2017 |
| 68 | Ndërtimi i çerdhës së fëmijëve projekt trevjeçar | 336.800,00 | 2017 |
| 69 | Rehabilitimi i fushës sportive në fshatin Stroc | 10.000,00 | 2017 |
| 70 | Ndërtimi i shkollës "Bajram Curri" në fshatin Dumnicë projekt dyvjeçar | 200.000,00 | 2017 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 71 | Ndërtimi i fushës sportive në ...hatin Pestovë | 14.000,00 | 2017 |
| | | **4.272.902,00** | |

Secili proces i prokurimit do të administrohet përmes 8 hapave, si në vijim:

| | |
|---|---|
| Hapi 1 | Planifikimi i prokurimit |
| Hapi 2 | Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës |
| Hapi 3 | Përcaktimi i vlerës së prokurimit |
| Hapi 4 | Përgatitja e dosjes së tenderit |
| Hapi 5 | Publikimi |
| Hapi 6 | Hapja dhe vlerësimi i tenderëve |
| Hapi 7 | Dhënia dhe nënshkrimi i kontratës |
| Hapi 8 | Menaxhimi i kontratës |

## Administrata

### Sektori i Gjendjes Civile

| Qëllimi kryesor | Aktiviteti | Vlera në € | Afati | Pjesëmarrë-sit tjerë | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Plotësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile; mbajtja e akteve të gjendjes civile; lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile; ofrimi i shërbimeve më efikase dhe më të shpejta për qytetarë; | 1. Furnizimi me regjistra të gjendjes civile dhe certifikata; furnizimi me kompjuterë dhe pajisje përcjellëse (printerë, fotokopjues, skanerë,etj.) dhe furnizimi me material shpenzues për nevoja të gjendjes civile. | 6,000.00 | Janar-mars prill-qershor korrik-shtator tetor-dhjetor | | |
| | 2. Lëshimi i certifikatave, dokumenteve të gjendjes civile. | | Sipas afateve ligjore | | |
| | 3. Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile (lindje, martesa,vdekje etj). | | Sipas afateve ligjore | | |
| | 4. Përditësimi dhe administrimi i të dhënave të gjendjes civile në regjistrat fizikë dhe në regjistrin elektronik. | | Sipas afateve ligjore | | |
| | 5. Kurorëzimet, organizimi i ceremonisë së | | Sipas afateve | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| organizimi, mbajtja e trajnimeve dhe aftësimi profesional i zyrtarëve të gjendjes civile, si dhe aplikimi i sistemit online për qytetarë. | kurorëzimeve, pajisja me certifikatë dhe broshurë familjare. | | ligjore | | |
| | 6. Regjistrimi i shtetasve në regjistrin fizik dhe elektronik dhe pajisja me certifikata të shtetësisë, si dhe aplikimi për natyralizim i shtetasve të huaj dhe aplikimi për humbje të shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim. | | Sipas afateve ligjore | | |
| | 7. Përmirësimet dhe korrigjimet e shënimeve personale në regjistrat e gjendjes civile, ndërrimi i emrit personal dhe përcjellja e shënimeve të mëvonshme me anë të shënimeve në regjistrat e gjendjes civile. | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| **Totali** | | **6,000.00** | | | |

Sektori:-Qendra për shërbime të qytetarëve

| Nr. | Qëllimi kryesor | Aktiviteti | Vlera në € | Afati | Pjesëmarrësit tjerë | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Ofrimi i shërbimeve për qytetarë | Komunikimi korrekt me qytetarë. | | | Udhëheqësi i qendrës dhe personeli ndihmës. | |
| 2. | | Përgatitja dhe vënia në dispozicion e broshurave, informative për qytetarë dhe publikimi në UEB. | | | Udhëheqësi i qendrës në bashkëpunim me zyrtarin për informim. | |
| 3. | | Këshillimi dhe ndihma juridike për mënyrën e plotësimit të kërkesave dhe parashtresave. | | | Udhëheqësi i qendrës dhe personeli ndihmës. | |
| 4 | | Pranimi dhe regjistrimi i kërkesave. | | | Asistenti në qendrën për shërbim të qytetarëve | |
| 5. | | Mbajtja e evidencës për kërkesa dhe parashtresa. | | | Asistenti | |
| 6. | | Shpërndarja e kërkesave nëpër organe të komunës. | 200.00 | | Asistenti | |

Sektori për punë të përbashkëta kontraktuese dhe teknologji informative

| Nr | Objektivi | Aktiviteti | Vlera në € | Afati | Pjesëmarrësit tjerë | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Avansimi në | Kujdesi për | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përdorimin e E-Qeverisjes. | zbatimin e politikës të sigurisë së rrjetit. | | | | |
| 2. | | Mirëmbjtja, ofrimi i mbështetjes për rrjetin kompjuterik të komunës. | | | | |
| 3. | | Ofrim i ndihmës për personelin e Administratës komunale në përdorimin e TI. | | | | |
| 4. | | Mirëmbajtja e TI. | | Sipas nevojës | | |
| 5. | | Furnizimi me pajisje dhe mobilie për nevoja të gjendjes civile. | 1,000.00 | Janar-dhjetor | | |
| 6. | | Furnizimi me pajisje të TI, për nevoja të Administratës së komunës. | 2,000.00 | Prill - qershor | | |
| 7. | Respektimi i rregullave të drejtshkrimit. | Lekturimi i dokumenteve zyrtare të komunës. | | Sipas detyrës zyrtare | Zyrtari për lekturim | |
| 8. | Zbatimi i akteve ligjore për gjuhët zyrtare në komunë. | Përkthimi i dokumenteve zyrtare të komunës. | **Totali 3,000.00** | Sipas detyrës zyrtare | Zyrtari për përkthim | |
| 9. | Sigurimi i objektit të komunës. | Përkujdesja 24 orë për ruajtjen e objektit të komunës dhe autoparkut. | 35,000.00 € | Në bazë të kontratës | Kompania "PANTHER" në bazë të kontratës | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | Mirëmbajtja e objektit të komunës. | Mirëmbajtja e higjienës në objektin e komunës, gjatë ditëve të punës. | 30,000.00 € | Në bazë të kontratës | Kompania "VENDA" Vushtrri | |
| 11 | Krijimi i kushte-ve adekuate për punë, për personelin e komunës. | | | | Drejtoria për Administratë | |
| | **Totali** | | **65,000.00 €** | | | |

**Sektori: Njësia për të Drejtat e Njeriut**

| Nr. | Objektivi | Aktiviteti | Vlera në € | Afati | Pjesëmarrësit tjerë | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Lehtësim i punës së punëtorëve të komunës | Furnizim për zyrë | 560.00 | Mars 2014 | | |
| 2. | Avancimi i të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, të drejtave të fëmijëve dhe komuniteteve në komunën tonë | Shënimet e datave për të drejtat e njeriut, barazi gjinore | 2,500.00 | | Koordinatorja e NJKDNJ,ZDK, ZDF | |
| | **Totali** | | **3,60.00** | | | |

Shërbimet e udhëtimit dhe telekomunikacionit nga Vala 900

| Nr. | Objektivi | Aktiviteti | Vlera në € | Afati | Pjesëmarrësit tjerë | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Trajnime dhe pjesëmarrje të ndryshme për stafin e administratës | | 1,000.00 | Janar-dhjetor | | |
| 2. | Shërbime postare | | 500.00 | | | |
| 3. | Lehtësim i komunikimit mes punëtorëve të administratës, për ofrim sa më të mirë të shërbimeve për qytetarë | | 16,7000.00 | Janar-dhjetor | | |
| | **Totali** | | **18,200.00** | | | |

Furnizime të ndryshme për administratë

| Nr. | Objektivi | Aktiviteti | Vlera në € | Afati | Pjesëmarrësit tjerë | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Lehtësim i punës së punëtorëve të komunës | Furnizim për zyrë | 13,000.00 | Janar- | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe për pastrim | | dhjetor | | |
| 2. | Lehtësim i punës së punëtorëve të komunës | Furnizim me derivate | 20,100.00 | Janar-dhjetor | | |
| | **Totali** | | **33,100.00** | | | |

Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe reprezentacionit

| Nr. | Objektivi | Aktiviteti | Vlera ne € | Afati | Pjesëmarrësit tjerë | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Lehtësim i punës së punëtorëve të komunës | Mirëmbajtja e TI, pajisjeve dhe ndërtesave | 4,000.00 | Janar-dhjetor | | |
| 2. | Përfaqësimi i komunës | Shpenz.e reprezentacionit | 500.00 | Janar-dhjetor | | |
| | **Totali** | | **4,500.00.** | | | |

**Urbanizmi**

| | Aktiviteti | perioda | në bashkëpunim | vërejtje |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Inicimi i prodeurave për asfaltimin e rrugëve të aprovuara nga KK Vushtrri | Janar - dhjetor | Me Drejtorinë e Financave dhe Drejtorinë e Prokurimit | |
| 2 | Mbikëqyrja e projekteve kapitale të komunës | Janar - dhjetor | Me Drejtorinë e Financave dhe Drejtorinë e Prokurimit dhe drejtoritë tjera | |
| 3 | Kujdesi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë | Janar - dhjetor | Drejtorinë për Kulturë dhe Entin për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturo-historike të Kosovës | |
| 4 | Identifikimi i hapësirave të reja, pronë komunale për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë | Janar - dhjetor | | |
| 5 | Incicimi i proceduravev për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së | Janar - dhjetor | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Vushtrrisë | | | |
| 6 | Hartimi i pëlqimeve urbanistike, caktimi i pikave të ndërtimit, si dhe lëshimi i lejeve ndërtimore | Janar - dhjetor | Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë / dhe Inspektimeve | |

Do të punohet në shpenzimin e buxhetit të paraparë për asfaltimin e rrugëve në tërë territorin e komunës në bazë të listës së miratuar me buxhetin e komunes. Shumat për buxhetin e planifikuar janë paraqitur në Planin e punës të Drejtorisë për Prokurim publik.

Sa i përket planifikimit të të hyrave vetanake për vitin 2017, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit do të hartojë një plan për realizimin e të hyrave vetanake nga:

- Lejet e ndërtimit;
- Shfrytzimi i tokës afatshkurtër dhe afatgjatë;
- Lejet mjedisore komunale;
- Legalizimi i objekteve pa leje;
- Hapësirat publike;
- Pëlqimet e ndryshme etj.

**Arsimi**

Prioritetet kryesore në fushën e arsimit:

- Inkurajimi për reforma për mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Monitorimi i vazhdueshëm i përgjegjësisë individuale e kolektive;
- Vazhdimi i zbatimit të kurrikulës së re në shkollat pilot, si dhe përgatitja për përfshrije të shkollave tjera;
- Promovimi i suksesit të nxënësve dhe mësimdhënësve, si dhe nxitja për zhvillimin e dijeve;
- Vlerësimet e jashtme;
- Monitorimi dhe mentorimi i mbarëvajtjes së procesit mësimor;
- Gjithëpërfshirja në arsim;
- Praktikat profesionale, hap i rëndësishm për punësim;
- Përfshirja e parashkollorëve në shkollat publike;
- Arritja e rezultateve të kënaqshme në shkollimin parafillor, fillor dhe të mesëm në përputhje me reformat në arsim që janë duke u bërë në mënyrë permanente nga MASHT-i.

Paraqitja tabelare:

| Nr. | Objektivat | Aktivitetet | Financuar në Euro | Afati | Pjesëmarrësit e tjerë | Ndërlidhja më tjerë | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | *Monitorimi i vazhdueshëm i përgjegjësisë individuale e kolektive* | 1.1. Monitorimin e mirëmbajtjes së pastërtisë në shkolla | | JANAR-DHJETOR | DKA | Zyrtarët e DKA-së | |
| | | 1.2. Sigurimin e objekteve shkollore | | JANAR-DHJETOR | | • DKA<br>• Drejtoria e prokurimit | |
| | | 1.3. Monitorimin e shpenzimeve komunale në secilën shkollë të komunës | | JANAR - DHJETOR | DKA | Zyrtarët e DKA-së | |
| 2 | Sigurimi i udhëtimit për | 2.1.Transporti i nxënësve për fëmijë më nevoja të veçanta | | JANAR - QERSHOR | DKA Drejtoria | Zyrtarët e DKA-së | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | fëmijë më nevoja të veçanta | | | SHTATOR-DHJETOR | prokurimit | | |
| 3 | Cilësia në sistemin e arsimit parauniversitar | 3.1. Reformimi i procesit të mësimdhënies<br>3.2. Funksionimi i koordinatorëve të cilësisë | | JANAR-DHJETOR | Ekipet e ERPB-së MASHT DKA | Zyrtarët e DKA-së | |
| 4 | *Vazhdimi i zbatimit të kurrikulës së re në shkollat pilot si dhe përgatitja për përfshrijen të shkollave tjera* | 4.1. Vazhdimi i trajnimimit të mësimdhënësve konform kurrikulës së re | | JANAR - DHEJTOR | MASHT | Zyrtarët e DKA-së | |
| | | 4.2. Vazhdimi i trajnimit të personelit udhëheqës të shkollave dhe rritja e përformancës së vlerësimit të punës | | JANAR - DHJETOR | MASHT BEP.US AID | Zyrtarët e DKA-së | |
| | | 4.3. Invenatarizimi i mjetve didaktike për zbatimin e kurrikulës së re në shkollat pilot | | SHKURT-MARS | MASHT | Zyrtarët e DKA-së | |
| | *Promovimi i suksesit të* | 6.1. Organizmi i vlerësimit të njohurive të nxënësve, duke filluar nga klasa e pestë e deri te e nënta | | MARS-QERSHOR | DKA | Zyrtarët e DKA-së | |
| | | 6.2. Kuizi i diturisë | | MARS, QERSHOR, | DKA | Zyrtarët e DKA-së me mësimdhënës | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | *nxënësve dhe mësimdhënësve, si dhe nxitja për zhvillimin e dijeve* | | | NENTOR | | | |
| | | 5.3. Organizimi i garave të ndryshme artistike, kulturore dhe sportive | | MARS - QERSHOR | DKA | Zyrtarët e DKA-së me mësimdhënës | |
| | | 5.4. Organizimi i olimpiadës së matematikës dhe gjuhëtari i ri | | MARS-MAJ | DKA, SIA MITROVICË | Zyrtarët e DKA-së me mësimdhënës | |
| | | 5.5. Nxitja e nxënësve dhe promovimi i dijes në olimpiada që mbahen jashtë komunës dhe stimulimi | 100 Euro për secilin vend të parë në nivel vendi | MARS - QERSHOR | DKA | Zyrtarët e DKA-SË | |
| 6 | *Vlerësimet e jashtme* | 6.1.Organizmi i provimit të maturës shtetërore 2017 | | QERSHOR-SHTATOR | MASHT | DKA | |
| | | 6.2. Organizimi i testit të arritshmërisë 2017 | | QERSHOR-SHTATOR | MASHT | DKA | |
| 7 | *Plotësimi i vendve të lira të punës* | 7.1. Përgatitjet për shpalljen e konkursit për vendet e lira të punës për mësimdhënës | | QERSHOR-KORRIK | DKA | | |
| | | 7.2. Përgatitja për shpalljen e konkursit për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë të shkollave. | | Janar-Dhjetor | DKA | MASHT | |
| | *Performanca e shkollës* | 9.1. Vlërësimi i brendshëm i shkollës | | JANAR - DHJETOR | Zyrtarët e DKA-së | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | | 8.2. Vlerësimi i jashtëm i shkollës | | JANAR - DHJETOR | Zyrtarët e DKA-së | SIA | |
| 9 | *Gjithëpërfshirja në arsim* | 9.1.Përfshirja e gjithë nxënësve në arsim pa marrë parasysh gjuhën dhe etninë | | JANAR- DHJETOR | Zyrtarët e DKA-së | | |
| | | 9.2. Funksionimi i ekipit për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore | | JANAR- DHJETOR | Zyrtarët e DKA-së | | |
| | | 9.3. Ofrimin, motivimin, këshillimin, sugjerimin, si dhe marrjen e masave për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në klasat e rregullta | | JANAR - DHJETOR | Zyrtarët e DKA-së | | |
| 10 | *Praktikat profesionale, hap i rëndësishm për punësim* | 10.1.Bashkëpunimi me ndërrarrje punuese, angazhimet për kryerjen e | | SHKURT- DHJETOR | Zyrtarët e DKA-së | DKA | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | praktikave | | | | | |
| 11 | *Parashkollorët të përfshirë në shkollat publike* | 11.2.Përfshirja progresive e nxënësve parashkllorë krahas buxhetit | | SHTATOR | MASHT | DKA | |
| 12 | Bashkëpunimi i me organet e sigurisë: Policinë, FSK-në KFOR-in, OJQ-të, mediat, si dhe më organizata të ndryshme vendore e të huaja | 12.1. Koordinimi i aktiviteteve<br>12.2. Pjesëmarrje në debate<br>12.3 Identfikimi i nevojave të përbashkëta | | Janar-Dhjetor | | DKA<br>OJQ<br>KFOR<br>FSK | |
| 13 | Riatdhesimi i nxënësve | 13.1. Identifikimi i të kthyerve<br>13.2.Mbajtja e kursve plotësuese<br>13.3. Inegrimi i nxënësve | | Janar-Qershor | | DKA | |

**Shëndetësia dhe përkujdesja sociale**

Objektivat kryesore në fushën e shëndetësisë:

1. Përmirësimi i shëndetit të qytetarëve - parandalimi i sëmundjeve, përkujdesja për të sëmurit, trajtimi mjekësor, diagnostifikimi i hershëm i sëmundjeve, ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, referimi i pacientëve në shërbime specialistike konsultative bazuar në kriteret profesionale, kurse sipas indikacioneve edhe referimi në nivelin dytësor, tretësor dhe për trajtim jashtë vendit në pajtim me kompetencat ligjore.
2. Furnizimi më i mirë me barëra dhe material shpenzues nga Lista esenciale e barërave e cila është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe përmes realizimit të procedurave tona të prokurimit në pajtim me mundësitë buxhetore dhe kompetencat ligjore.
3. Përmirësimi i kujdesit për pacientë me çrregullime mendore e sidomos të atyre që kanë pësuar çrregullime si pasojë e përjetimeve në luftën e fundit.
4. Promovimi shëndetësor për të rinj me qëllim të ngritjes së edukatës shëndetësore në parandalimin e sëmundjeve ngjitëse seksualisht të transmetueshme siç janë: (gonorea, sifilizi, HIV-AIDS), alkoolizmi, narkomania, prostitucioni, delikuenca e të tjera, nëpërmes ligjëratave, fletëpalosjeve, mjeteve të shkruara elektronike etj.
5. Imunizimi i fëmijëve me qëllim të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse, kontrollin e ujit të pijshëm, promovimin e ushqimit të shëndoshë.
6. Organizimi i vizitave sistematike i nxënësve me qëllim të zbulimit të hershëm të sëmundjeve të ndryshme siç janë: anomalitë kongjenitale (ngecjet trupore, mendore, shqisore, deformitetet e lindura), zbulimi i hershëm i rakitit, kariesit, sëmundjeve ngjitëse (pedikuloza, skabiesi etj).
7. Zhvillimi i rrjetit shëndetësor duke përfshirë mirëmbajtjen, renovimin, pajisjen me aparaturë të nevojshme etj.
8. Avancimi i SISH-it.
9. Bashkëpunimi me të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor dhe social, përfshirë organizatat qeveritare dhe joqeveritare, donatorët e ndryshëm dhe njerëzit e vullnetit të mirë.

Qendra kryesore e mjekësisë familjare

| Objektivat | Bartës | Afati kohor | Vërejtje |
|---|---|---|---|
| Funksionalizimi QMF 2 te shkolla "A.Z. Çajupi"dhe QMF 3. | DSHPS, QKMF | Janar/shkurt 2017 | |
| Vazhdimi i specializimit të mjekëve nga Mjekësia familjare dhe specializimeve të tjera të nevojshme për nevojat e QKMF-së dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. | MSH, DSHMS, QZHMF, QKMF. | Gjatë vitit | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Vazhdimi i programit të trajnimit nga Mjekësia familjare | MSH, DSHMS, QZHMF, QKMF. | Në kontinuitet | Kuadri mjekësor do të përfshihen në program të trajnimit nga mjekësia familjare, në pajtim me mundësitë dhe vendimet e KD të QKMF-së. |
| Zhvillim i vazhdueshëm profesional, infermierë dhe mjekë të kuadrove ekzistuese | Komitete ti për: ZHVP, QZHMF, QKMF, QMF. | Në kontinuitet | ZHVP është obligativ për të gjithë profesionistët shëndetësorë me qëllim të arritjes së pikave të caktuara për rilicencim. Plani detal do të behët nga zyrtari për ZHVP. |
| Zonimi dhe regjistrimi i pacienteve nëpër QMF dhe ambulance; Avancimi i punës ekipore dhe rrjedhës së pacientëve; Caktimi i vizitave kontrolluese me termine të caktuara. | QKMF, QMF, AMF. | Në kontinuitet | Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe ndarja e përgjegjësive nga ana e personelit shëndetësor . |
| Implementimi i projektit për përmirësimin e qasjes ndaj shërbimeve të planifikimit të familjes dhe shëndetit riprodhues | QKMF, QMF, AMF. | Gjatë vitit | Aktiviteti zhvillohet në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare të specializuara dhe me MSH- në. |
| Zbulimi dhe lajmërimi me kohë i sëmundjeve ngjitëse, sëmundjeve malinje dhe sëmundjeve tjera jo ngjitëse. | Mjekë të praktikës së përgjithshme, mjekë speciali. familjarë, stomatologë | Në kontinuitet | Raportimi i sëmundjeve ngjitëse në Institutin Rajonal të Shëndetësisë Publike i rregullt nga çdo mjek dhe informata kthyese nga instituti. |
| Funksionimi i rrjetit të telemjekësisë | MSH, QKUK . | Gjatë vitit | Përmes telemjekësisë arrihet trajnim i vazhdueshëm i personelit shëndetësor. |
| Funksionalizimi i sistemit të patronazhit në dy ekipe | DSHPS, QKMF. | Gjatë vitit | Funksionalizimi i tillë është shumë i nevojshëm dhe me rëndësi të veçantë për shëndetin e qytetarëve. |
| Funksionalizimi i shërbimit stomatologjik 24 h, dhe shtrirjen e tij në dy fshatra. | DSHPS, QKM. | Qershor | Furnizimi me pajisje është realizuar dhe me pranimin e mjekëve stomatologë do të funksionalizohet. |
| Hartimi i "Master Planit" në bashkëpunim me donatorë | DSHPS, QKMF. | Gjatë vitit | Master plani është dokument strategjik i cili do të hartohet në |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | bashkëpunim me donatorë zviceran. |

Edukimi i personelit

| Objektivat | Realizimi i objektivave | Planifikimi i realizimit | Vërejtje |
|---|---|---|---|
| Dërgimi i kuadrove profesionale në konferenca, seminare, simpoziume të ndryshme, vendore e ndërkombëtare për të mundësuar ngritjen profesionale të tyre dhe grumbullimi i pikëve të nevojshëm për rilicencim | MSH, DSHMS, QKMF | Gjatë vitit | Kjo do të arrihet nëse ekzistojnë mundësitë financiare apo mbështetje nga donatorët. |
| Qasja e vazhdueshme në internet dhe qasje në të dhëna të reja mjekësore | QKMF, Mjekët, Mjekët specialist. | Në kontinuitet | Kyçja në internet dhe më qendra të tjera të mjekësisë familjare (varësisht nga mjetet financiare dhe mundësitë teknike). |
| Ligjërata interaktive me tema të zgjedhura nga 6 modulet e infermierisë familjare për personelin e mesëm shëndetësor | QKMF, infermierë për edukim shëndetësor. | Në kontinuitet | Më qëllim të arritjes së shkathtësive dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Plani detal i ligjëratave duhet bashkëngjitur. |
| Organizimi i kurseve të emergjencës mjekësore | Mjekët, infermierët e emergjencës. | Gjatë vitit | Kurse të tilla janë të parapara më Ligjin për Emergjenca dhe vijohen në Departamentet e Emergjencave Mjekësore në QKUK në bashkëpunim më institucionet që trajtojnë emergjencat |
| Aktivitetet edukativo-mësimore nga lëmi të ndryshme për mjekë familjarë, mjekë të praktikës së përgjithshme dhe infermierë. | Komiteti për ZHVP. | Gjatë vitit | Është pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional |
| Trajnimi i personelit të QKMF-së mbi përdorimin e aparateve për shuarjen e zjarrit | QKMF. | Gjatë vitit | Në rast të shpërthimit të zjarrit mbi përdorimin e aparateve kundër zjarrit |

Edukimi i popullatës

| | | | |
|---|---|---|---|
| Edukim i pacientëve i fokusuar në sëmundje kronike, sëmundje infektive, shëndetit reproduktiv, fëmijët deri në moshën 5 vjeçare, kujdesi paliativ (pacientët më nevoja speciale), shëndetin mendor etj. | QKMF, QMF, infermierë për edukim shëndetësor | Gjatë vitit | Raportet e obliguara mujore në lidhje me punën në komunitet nga secila QKMF, QMF dhe AMF. |
| Edukimi shëndetësor i nxënësve të shkollave fillore për | QKMF, infermierët për | Gjatë vitit | Bashkëpunimi më drejtorët dhe mësimdhënësit në shkolla më qëllim të ngritjes së higjienës |

| | | | |
|---|---|---|---|
| higjienën personale dhe orale | edukim shëndetësor, IRSHP. | | ...rsonale të nxënësve. Kjo do të realizohet ...ëse ekzistojnë mundësitë financiare. |
| Edukimi i të rinjve nëpër shkolla i orientuar në tema mbi disa dukuri negative në shoqëri me të cilat ballafaqohet rinia si: abuzimi i drogave, alkoolizmi, pirja e duhanit, prostitucioni, delikuenca, shtatëzanitë e padëshirueshme, kontracepsioni, sëmundjet seksualisht të transmetueshme: gonoreja, sifilisi, HIV-AIDS etj. | QKMF, Infermierët për edukim shëndetësor, IRSHP | Gjatë vitit | Hulumtimi i donatorëve të ndryeshëm për realizimin e projektve në shkolla më qëllim të furnizimit me material edukativ (fletushka, revista,) etj. |
| Edukimi në komunitet përmes radios, fletëpalosjeve, sidomos në shënimin e Ditës ndërkombëtare të sëmundjeve të ndryshme: TBC-së, HIV-AIDS, kundër kancerit, pirjes së duhanit etj. | Infermierët e edukimit shëndetësor | Gjatë vitit | Bashkëpunimi më IRSHP |
| Edukimi shtesë i popullatës në rast të paraqitjes së epidemive | QKMF, | Gjatë vitit | Involvimi i të gjitha strukturave udhëheqëse shëndetësore dhe institucioneve shëndetësore: IRSHP, IKSHP, OBSH etj. |
| Vizitat sistematike për klasat e para dhe parashkollorë | DSHPS QKMF | Shtator/ tetor | |

## QENDRA PËR PUNË SOCIALE

QPS aktivitetin e vet do të zhvillojë në: Mbrojtjen sociale të fëmijëve pa përkujdesje prindërore, të rinisë me sjellje asociale, mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve më nevoja të veçanta, të rriturve në gjendje të nevojës sociale, të moshuarve pa kujdes familjar dhe pa mjete për jetesë, punët e kujdestarisë. QPS do të ofrojë shërbime dhe aktivitete preventive më qëllim të parandalimit dhe pengimit të dukurive negative, punë rreth adaptimit, strehimit të fëmijëve, si dhe kërkesa tjera të qytetarëve në kompetencë të qendrës.

I. Shërbimet sociale -Mbrojtja e drejtpërdrejtë e shfrytëzuesve

Fëmijët dhe rinia: Trajtimi adekuat dhe mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindëror më qëllim të sigurimit të mbështetjes individuale familjare për një të ardhme në kuptim të mirëfilltë. Qëllimi kryesor i punës me këtë kategori do të jetë edhe përmirësimi kualitativ i jetës së tyre, edukim dhe ofrim i përkrahjes së vazhdueshme ndaj tyre. Kjo do të behët në vënie nën kujdestari, vendosje në strehim familjar, në strehim institucional, OJQ- të përkatëse dhe përkujdesja e përhershme mbi gjendjen e tyre.

2. Fëmijët e keqtrajtuar, të rrezikuar nga dhuna familjare dhe të lënë pas dore. Do të ndërmerren masa të mbrojtjes, të cilat kanë për qëllim kapërcimin e situatave të rrezikuara familjare në të cilat fëmijët janë viktima të dhunës apo lënie pas dorës.
3. Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve që kanë rënë në konflikt më ligjin. Ndonëse puna me këto raste kërkon përkushtim të veçantë, angazhimi i shërbimit social do të përqendrohet jo vetëm në klientin, por edhe në punën me fëmijë, shkolla SHPK-në, gjykata dhe institucione të tjera.
4. Mbrojtja e fëmijëve prindërit e të cilëve janë shkurorëzuar. Prioritet i punës me këto raste do të jetë mbrojtja e interesave të fëmijëve, përcjellja e gjendjes së tyre, si dhe rregullimi i kontaktimit të tyre me prindin tjetër.
5. Mbrojtja e fëmijëve me nevoja të veçanta. Do të ofrohen shërbime në bashkëpunim me subjektet e tjera të implikuara në ofrimin e shërbimeve kësaj kategorie. Do të bëjmë identifikimin e tyre, kategorizimin dhe kompensimin e familjeve më të holla varësisht nga mjetet që lejon buxheti i Kosovës.
6. Mbështetja e fëmijëve viktimë e trafikimit, prostuticionit punës së rëndë dhe formave të tjera do të jetë objektiv afatgjatë në mbrojtjen dhe në ri-integrimin e këtyre fëmijëve në ambient të shëndoshë familjar e shoqëror.
7. Të rinjtë që kërkojnë mendim për hyrje në martesë para moshës madhore do të trajtohen në bazë të procedurave psiko-sociale.
8. Shërbimet tjera janë çështje e trashëgimisë, kërkesat lidhur më zotësinë e veprimit të ushtrimit të drejtës prindërore, vërtetime mbi aftësinë e të ngjashme.

9.Të rriturit: Shqyrtimi i kërkesave të rriturve për zgjidhjen e martesave dhe marrëdhënieve të çrregulluara familjare. Do të punohet me bashkëshortët në zgjidhjen e martesës dhe përmasimin e marrëdhënieve të çrregulluara familjare.
10.Të moshuarit: Organizimi i mbrojtjes së personave të moshuar të cilët për shkak të rrethanave të ndryshueshme familjare kanë mbetur pa përkujdesje familjare dhe pa mjete për jetesë.

II. Shërbimet e asistencës sociale
- Trajtimi në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, si dhe informimi dhe udhëzimi i qytetarëve lidhur më kriteret e parapara për të drejtën e aplikimit në ndihmë sociale.
- Raportimi mbi punën e shërbimit të SAS-it drejtuar Divizionit të SAS-it dhe DMS në Prishtinë, si dhe raportet dërguar organit përgjegjës në Kuvendin Komunal në Vushtrri.
- Do të bëhet informimi i aplikuesve për afatet e aplikimit dhe riaplikimet në SNS për kategorinë e parë dhe të dytë, shqyrtimi i kërkesave, përgjigjja në afat ligjor, prezantimi i të dhënave, koordinimi i punës më komision mjekësor, raportimi mujor, periodik dhe vjetor, ruajtja e konfidencialitetit, kujdesje permanente për implementimin dhe realizimin e nevojave dhe përcjelljen e shpenzimeve të të dhënave lidhur me mjetet financiare.

Qendra " Shtëpia për Komunitet" në Lumadh - Planifikimi vjetor për shtëpinë në komunitet

| | | | |
|---|---|---|---|
| Avancimi i metodave të punës i stafit të qendrës | DSHPS Qendra në komunitet | Gjatë vitit | Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave të fituara nga marrëveshja me Komunën e Vaxjos, do të ndihmojnë në përmirësimin e metodave të punës me klientë. |
| Trajnimi i stafit | | | Stafi përmes bashkëpunimit mund të trajnohet për shumë fusha të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | DSHPS | Gjatë vitit | shërbimeve që ofrojnë në qendër. |
| Përcaktimi i aktiviteteve që do të zhvillojnë klientët në objekt | Qendra në komunitet | Janar/shkurt | Qendra në komunitet do të përcaktojë listën e aktiviteteve vjetore të punës me klientë |
| Vizitat shëndetësore të klientëve | DSHPS QKMF | Gjatë vitit | QKMF me ekip mjekësor në baza periodike do të realizojë vizita sistematike për klientë në qendër. |
| Realizimi i projekteve kapitale - ndërtimi i serrave për rezidentë dhe rregullimi i kopshtit | DSHPS QENDRA | Gjatë vitit | |
| Vizita në qendrat e njëjta në Suedi për 3 punëtorë të qendrës. | DSHPS | Janar | |

V. Funksionalizimi i qendrës speciale për fëmijë me nevoja të veçanta

DSHPS në bashkëpunim me donatorë ka arritur të sigurojë donacion në vlerë prej 85.000 për ndërtimin e Qendrës speciale për fëmijë me nevoja të veçanta në Nedakoc. Punimet në këtë qendër do të përfundojnë në shkurt të vitit 2017. Funksionalizimi i saj do të bëhet përmes bashkëpunimit me donatorin, MPMS, Qendrës rezidenciale në Lumadh dhe OJQ-të që implementojnë shërbimet sociale. Plani konkret i kësaj qendre do të detajizohet pas përpilimit të tij të pëbashkët nga të gjithë akterët e mundshëm.

**Shërbimet Publike**

| | Aktiviteti | Periudha | Në bashkëpunim |
|---|---|---|---|
| 1 | Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale | Janar | |
| 2 | Konkursi për ndarjen e linjave për transportin urbano-periferik të udhëtarëve, reduktimi dhe sistemimi i kombibusëve, si dhe vendosja e tyre në ndonjë vendparkim | Janar | Bashkëpunimi me pronarët e kombibusëve, Drejtorinë për Inspektime |
| 3 | Mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik dhe i kanaleve të hapura | Mars | |
| 4 | Pastrimi i lumenjve në komunë | Gjatë gjithë vitit | |
| 5 | Plani i aktiviteteve për shënimin e muajit të higjienës | Mars-prill | Drejtoria për Inspektime, KRH " Uniteti" dhe OJQ. |
| 6 | Mirëmbajtja e varrezave | Prill-maj | |
| 7 | **Mirëmbajtja** (mirëmbajtja verore - plani i fshirje-larjes së rrugëve në | Mars | Drejtoria për Buxhet, Thesar |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | qytet. 01.04.2017– 31.03.2018, mirëmbajtja e varrezave të qytetarëve, martirëve dhe dëshmorëve, mirëmbajtja dimërore) | | dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim |
| 8 | Eliminimi i deponive ilegale | Mars-Prill | Drejtoria për Inspektime |
| 9 | Incizimi, analizimi i madhësisë dhe dendësisë së qarkullimit në rrugët e qytetit për verifikim të senseve të lëvizjes. | Shtator | Policinë e Kosovës, nxënësit e komunikacionit |
| 10 | Plani i zgjerimit të veprimit të KRH "Uniteti" SH.A. në qytet dhe nëpër fshatra të komunës | Gjatë tërë vitit, sipas nevojës | KRH "Uniteti" SH.A. |

Në bazë të planifikimit për të hyra vetanake për vitin 2017 do të realizohen të hyra vetanake nga: parkingjet, ndaljet e mjeteve për ngarkim-shkarkim, shërbimet me automerimangë, regjistrimi i mjeteve motorike, shfrytëzimi i trotuareve për ndërtime dhe renovime të ndryshme, reklamat, vërtetimet e rendeve të udhëtimit dhe pëlqime tjera.

**Inspektimet**

| | Aktiviteti | Bartësit e aktiviteteve | Planifikimi i realizimit | Lokacioni |
|---|---|---|---|---|
| | • Inspektimet tek personat fizikë dhe juridikë ku aktiviteti i tyre është profitabil - regjistrimin e biznesit;<br>• Inspektimet në mjetet transportuese në qarkullimin e mallrave – shitës ambulator dokumentacionin përcjellës për mallrat qe i ka në shitje;<br>• Të kërkojë nga subjekti i cili i nënshtrohet inspektimit t'i dërgojë të dhënat për furnizuesit e tyre;<br>• Mbikëqyrjen e aktivitetit të subjekteve ekonomike gjatë shitjes të produkteve ose ofrimit të shërbimeve;<br>• Regjistrimin e mallrave ekzistuese në objektin afarist, si dhe sigurimi i dëshmive të tjera të nevojshme;<br>• Kontrollimi i dokumentacionit, dëshmitë dhe informatat sipas lëndës së mbikëqyrjes inspektuese, si dhe të kërkoëj nga subjektet ekonomike që të përgatitin kopjet dhe dokumentet e nevojshme;<br>• Të kërkojë nga subjektet ekonomike që të hap dhe lejoj qasje në cilindo lokal, enë të mbyllura, makinë ose mjete të tjera;<br>• Të kërkojë nga cilido person që ka autorizim të dekodojë kodin me qëllim që të sigurojë qasje në dosjet kompjuterike, lokale dhe enë të mbyllura;<br>• Të kërkojë vërtetësinë e kopjeve me origjinën e dokumenteve, dëshmive dhe informatave të marra nga subjekti ekonomik me nënshkrimin dhe vulën e vet;<br>• Mbikëqyrja inspektuese kryhet pa paralajmërim në kohën kur subjekti ekonomik i kryen aktivitetet e tij ose në çfarëdo kohe tjetër kur kjo është e arsyeshme me qëllim të mbrojtjes të interesit publik ,jetës, shëndetit të njerëzve dhe pronës;<br>• Kontrollimi i librave afarist, mbajtja e evidences;<br>• Kontrollimi i dhënies së kuponëve (faturave) – konsumatorëve;<br>• Udhëzimet teknike, garancinë e mallrave, si dhe saktësia e dokumentacionit përcjellës;<br>• Inspektimi rreth respektimit të orarit të punës;<br>• Kontrollimin e dekleracionit të mallrave;<br>• Kontrollimi i kushteve minimale - teknike të lokaleve afariste;<br>• Inspektime te operatorët ekonomik, të cilët merren me shitjen-tregtimin dhe përpunimin e metaleve të çmueshme;<br>• Kontrollimi i faturave hyrëse dhe dalëse. | Inspektorët e tregut | Janar-dhjetor | Rruga:<br>Të caktuar sipas prioritetit në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë |

| | Aktiviteti | Bartësit e aktiviteteve | Planifikimi i realizimit | Lokacioni |
|---|---|---|---|---|
| 1 | • Inspektimi i bizneseve;<br>• Inspektimi i subjekteve hoteliere dhe subjekteve tjera tregtare.<br>• Inspektimi i institucioneve publike shoqërore dhe ato private, lidhur me:<br><br>- Kontrollimin e të gjitha subjekteve afariste që bëjnë transportimin e mallrave nga subjekti tek subjekti tjetër dhe kushtet e transportit të mallit, kualiteti, shërbimet;<br>- Kontrollimin tek subjektet shërbyese (librezat sanitare, uniformat e punëtorëve, kontrollimi i mallrave lidhur me afatet e përdorimit, pëlqimet sanitare, inspektimi i kushteve teknike i subjekteve afariste tregtare që merren me shumicë dhe pakicë dhe subjektet shërbyese, zejtare etj;<br>- Përcjelljen e analizave të ujit të pijes nga rezervuari i ujit;<br>- Pranimi ndhe shqyrtimin e kërkesave eventuale;<br>- Respektimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit tek subjektet afariste dhe institucionet publike. | inspektori sanitar | Janar - dhjetor | Rruga: Të caktuar sipas prioritetit në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë |

| Nr. | Aktiviteti | Bartësit e aktivitetit | Bashkëpunimi me subjekte tjera relevante | Afati |
|---|---|---|---|---|
| 2 | Lëshimi i lejeve të përdorimit së bashku me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | inspektorët e ndërtimit | Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Shkurt, mars |
| 3 | Marrja e të gjitha masave ligjore në rast të mospërfilljes së ligjeve dhe rregulloreve komunale, të cilat janë të aplikueshme nga ana e personave të cilët kryejnë ndërtime pa leje nga organi kompetent. | inspektorët e ndërtimit | Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Mars, prill |
| 4 | Masa ligjore, procedura për inicimin e procedurave për kundërvajtje në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje, për të gjithë ata pronarë, të cilët nuk kanë respektuar Ligjin për ndërtim. | inspektorët e ndërtimit | Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Prill, maj |
| 5 | Ndalimi i të gjitha punimeve në kundërshtim me ligjin bazuar në autorizimet ligjore. | inspektorët e ndërtimit | Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Maj |
| 6 | Ndalimin e të gjitha punëve ndërtimore pa leje nga organi kompetent. | inspektorët e ndërtimit | Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Gjatë tërë vitit |
| 7 | -Në raste të fillimit të punimeve ndërtimore pa leje do të merren të gjitha masat sipas dispozitave ligjore: Procesverbali për ndërprerje të punimeve pa leje dhe udhëzimi i palës të pajiset me leje ndërtimi;<br>-Aktvendimi për ndalim të punimeve shiriti rrethues, kërkesa për inicimin e procedurës për kundërvajtje, konkludimi për rrënimin e objektit. | inspektorët e ndërtimit | Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Gjatë tërë vitit |
| 8 | Bashkëpunimi me organet relevante, Policinë e Kosovës. | inspektorët e ndërtimit | Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Gjatë tërë vitit |
| 9 | -Bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër dhe Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;<br>-Caktimi i pikave për objektet me leje ndërtimore | inspektorët e ndërtimit | Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Gjatë tërë vitit |

| Nr. | PËRMBAJTJA E PUNËVE | BARTËSI I PUNËVE | BASHKËPUNON ME SUBJEKTET | AFATI I KRYRJES SË PUNËVE |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Angazhimi për të ndikuar në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe për të zvogëluar faktorët e ndotjes së mjedisit jetësor. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Bashkëpunim me subjektet relevante | Gjatë tërë vitit |
| 2 | Përgatitja e analizave, vlerësimeve dhe rekomandimeve për trajtimin në lëmenjtë e industrisë dhe burimeve urbane. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Gjatë tërë vitit |
| 3 | Angazhim në edukimin dhe në vetëdijesimin e popullatës në lëmin e mbrojtjes së mjedisit. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Bashkëpunim me qytetarët | Gjatë tërë vitit |
| 4 | Angazhim që lumenjve "Silnica" dhe "Tërstena" t'ua kthejmë funksionalitetin e mëparshëm për freskim, argëtim dhe peshkim. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | KRMH "Uniteti" njësia në Vushtrri | Gjatë tërë vitit |
| 5 | Gjatë muajit të higjienës të organizohen aksione me qytetarë, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, FSK-në, KFOR-in, si dhe me strukturat tjera për pastrimin e rrugëve kryesore dhe sheshеve para ndërtesave nga mbeturinat. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Kuvendi Komunal qytetarët, nxënësit, FSK-në, KFOR-in, KRMH "Uniteti" njësia në Vushtrri | Prill |
| 6 | Organizimi i fushatave për ngritjen e vetëdijes për mbeturina, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Kuvendin Komunal, Drejtorinë për Shërbime Publike | Gjatë tërë vitit |
| 8 | Përgatititja e programeve për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe pyllëzimin meliorativ të pyjeve të degraduara. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Autoriteti Qendror i Pylltarisë | Shkurt- mars |
| 9 | Mbrojtja e qytetarëve nga zhurma dhe vibracionet. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Autoriteti Qendror i Pylltarisë | Mars prill |
| 10. | Gjelbërimin e rrugëve kryesore me drunj dekorativ. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Kuvendi Komunal Drejtoria për Shërbime Publike | Prill |
| 11 | Gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e parqeve të qytetit. | -- | Kuvendi Komunal, DSHP | Gjatë tërë vitit |
| 12 | Ripyllëzimin e sipërfaqeve djerrë me fidane të reja dhe të shtojmë sipërfaqe të gjelbëruara në qytet. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Kuvendi Komunal | Gjatë tërë vitit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13 | -Mbikëqyrjen e zhvillimit të projekteve dhe respektimin e ndikimit në mjedis;<br>-Do të mbikëqyrim aplikimin e të gjitha procedurave në rastet e konstruktimit të projekteve zhvillimore në zonat e mbrojtura të natyrës, kushtet, lejet (licencat), si dhe zhvillimin e punëve se a janë në harmoni me lejen (licencën) e dhënë. | inspektori për mbrojtjen e mjedisit | Kuvendin Komunal<br>Drejtorin e Shërbimeve Publike,<br>KRMH "Uniteti" njësia në Vushtrri | Gjatë tërë vitit |

| Nr. | Aktiviteti | Bartësit i aktivitetit | Bashkëpunimi | Planifikimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Inspektimi i subjekteve afariste rreth ekspozimit të mallrave që nuk lejohen. | inspektori i shërbimeve publike | Bashkëpunim me subjektet relevante | Gjatë tërë vitit |
| 2 | Mbikëqyrje e shfrytëzimit të hapësirave publike. | inspektori i shërbimeve publike | Drejtorinë për Shërbime Publike | Gjatë tërë vitit |
| 3 | Mbikëqyrje e hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara. | inspektori i shërbimeve publike | Bashkëpunim me qytetarët | Gjatë tërë vitit |
| 4 | Mbikëqyrje mbi kyçjet me dhe pa leje në sistemin e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit. | inspektori i shërbimeve publike | KRMH "Uniteti" njësia në Vushtrri | Gjatë tërë vitit |
| 5 | Mbikëqyrje e mirëmbajtjes së kanalizimit, rrugëve, shesheve, trotuareve, tregut të gjelbër, terreneve sportive dhe parqeve. | inspektori i shërbimeve publike | Qytetarët, nxënësit | Gjatë tërë vitit |
| 6 | Mbikëqyrje e ndriçimit publik, mbishkrimet dhe reklamat. | inspektori i shërbimeve publike | Kuvendin Komunal,<br>Drejtorinë për Shërbime Publike | Gjatë tërë vitit |
| 7 | Mbikëqyrje e panove dhe reklamave të të gjitha llojeve. | Inspektori i shërbimeve publike | Kuvendin Komunal,<br>Drejtorinë për Shërbime Publike | Gjatë tërë vitit |
| 8 | Mbikëqyrje e të gjitha rrethojave përball sipërfaqeve publike. | Inspektori i shërbimeve publike | Bashkëpunimi me të gjithë resorët e inspektorëve, si dhe bashkëpunim i mirëfilltë me Policinë e Kosovës | Gjatë tërë vitit |

| Nr. | Aktiviteti | Bartësi i aktivitetit | Bashkëpunimi me subjekte tjera | Periudha kohore |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mbikëqyrje dhe inspektim i të gjithë operatorëve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarëve dhe mallrave. | inspektori i komunikacionit | Bashkëpunim me subjektet relevante (Policinë e Kosovës, gjykatën, inspektoratet qendrore dhe komunale | Gjatë tërë vitit |
| 2 | Operatorët "Taxi". | inspektori i komunikacionit | Drejtorinë për Shërbime publike | Gjatë tërë vitit |
| 3 | Inspektimi i Auto-Taxi-ve. | inspektori i komunikacionit | Drejtorinë për Shërbime publike | Gjatë tërë vitit |
| 4 | Inspektimin e automjeteve të transportit të mallrave. | inspektori i komunikacionit | Bashkëpunim me qytetarë | Gjatë tërë vitit |
| 5 | Ndërmarrjet të cilat merren me transport të udhëtarëve (autobusët, kombibusët). | inspektori i komunikacionit | Inspektoratet e resorëve tjerë | Gjatë tërë vitit |
| 6. | Kontrollimin e vijave komunale urbane dhe ndërurbane. | inspektori i komunikacionit | Drejtorinë për Shërbime publike | Gjatë tërë vitit |

| Nr | AKTIVITETI | BARTËSI I PUNËVE | BASHKËPUNIMI | AFATI I KRYRJES SË PUNËVE |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Angazhime të rregullta në mbikëqyrjen e mbajtjes se pastërtisë të vitrinave të lokaleve. | inspektorja e higjienës komunale | Drejtorinë për Inspektime dhe KRMH "Uniteti" | Përgjatë tërë vitit |
| 2 | Mbikqyrje e rrjedhjes se ujit, kanalizimit, pusetave, si dhe gropave septike kudo që ndodhen ato në territorin e komunës. | inspektorja e higjienës komunale | Drejtorinë për Inspektime dhe KRMH "Uniteti" | Përgjatë tërë vitit |
| 3 | Mbikëqyrje e mbajtjes se pastërtisë dhe pamjes së jashtme të ndërtesave. | inspektorja e higjienës komunale | Drejtorinë për Inspektime dhe banuesit e ndërtesave | Përgjatë tërë vitit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Inspektime të kohëpaskohshme për mbajtjen e pastërtisë së tregut. | inspektorja e higjienës komunale | Drejtorinë për Inspektime dhe pronarin e tregut | Përgjatë tërë vitit |
| 5 | Mbikëqyrje e pastërtisë së sipërfaqeve të gjelbëruara publike, terreneve sportive. | inspektorja e higjienës komunale | Drejtorinë për Inspektime dhe KRMH "Uniteti" | Përgjatë sezonës pranverore – vjeshtore |

**<u>Gjeodezi, kadastër dhe pronë</u>**

Aktivitetet që kanë për qëllim realizimin e prioriteteve të drejtorisë

| Nr | Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër | Objektivat | Aktivitetet | Afati | Ndikimi financiar | Pjesëmarrësit tjerë | Ndërlidhja me |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shpronësim i pronave për realizimin e projekteve | Zhvillimi i procedurave të shpronësimit | permanent | 100000 euro (80000 euro nga të hyrat vetanake dhe 20000 euro nga grantet) | Ministria e Financave | |
| | Prioritet nr. 1 Shpronësimi | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | prioritet nr. 2 Uzurpimet | | | | | | |
| 2 | | Mbrojtja e pronës komunale | Zhvillimi i procedurave për lirimin e pronës komunale të uzurpuar | permanent | | Drejtoria e Inspektimeve | |
| 3 | | Zbatimi i aktvendimeve lidhur me ndarjen e pronës nga komasacioni, e lëshuar nga komisioni për komasacion | Futja e të dhënave në RDPP për zonat kadastrale në komasacion të përfunduara | permanent | 25000 euro | Agjensioni Kadastral i Kosovës | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | | Vazhdimi i komasacio në 6 zona | Nxjerrja e aktvendimeve dhe futja e të dhënave në sistemin SIKTK | permanent | | Ministria e Bujqësisë | |
| 5 | | Rindërtimi i zonave kadastrale për 4 zona kadastrale | | permanent | | Agjensioni Kadastral i Kosovës | |
| 6 | | Ngritja e efikasitetit në punë | Përgjigjja në kohë ndaj kërkesave të paraqitura nga palët | permanent | zero | | |

**Mbrojtje dhe shpëtim**

| Nr | Emërtimi i detyrave-aktiviteteve të planifikuara | Baza e planifikimit | Bartësit e aktivite-teve | Bashkëpunimi më: | Afati | | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Prej | Deri | |
| **01** | Hartimi dhe azhurnimi i planeve: Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Plani për reagim emergjent. | Udhëzimi administrativ për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikut | DMSH | Kryqi i Kuq, Policia e Kosovës, NJPZSH, si dhe të gjitha bizneset që inkorporohen në këtë vlerësim | Gjatë vitit | Gjatë Vitit | |
| **02** | Bashkëpunimi dhe koordinimi me ekspertë të fushave përkatëse me interes të emergjencave civile. | Plani i punës | DMSH, | Drejtoritë komunale NJPZSH, OJQ, PK, Kryqi i Kuq | Gjatë vitit | Gjatë vitit | |
| **03** | Marrja e masave të nevojshme për parandalimin, zvogëlimin dhe sajimin e gjendjes të çdo dëmi që prek popullatën civile, të mirat e tyre materiale dhe pronën. | Plani i punës | DMSH, | Drejtoritë komunale, NJPZSH | Gjatë vitit | Gjatë vitit | |
| **04** | Angazhimi për pastrimin dhe hapjen e kanaleve nga vërshimet e ujit dhe pastrimin e rrugëve nga bora. | Plani i punës | DMSH | Drejtoritë komunale | Gjatë vitit | Gjatë vitit | |
| **05** | Formimi dhe aftësimi i ekipeve vullnetarëve për MSH. | Plani i punës | DMSH | OJQ- shoqëria civile, NJPZSH | Gjatë vitit | Gjatë vitit | |
| **06** | Identifikimi dhe vlerësimi i problemeve për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë tjera. | Plani i punës | DMSH | Të gjitha drejtoritë komunale, faktorët tjerë relevant | Gjatë vitit Përherë | Gjatë vitit Përherë | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mbrojtjes nga Zjarri | | inspektorë preventivës | | | |
| 13 | Koordinimi i punëve, aktiviteteve dhe menaxhimi i strehimoreve. | Plani i punës | DMSH | Drejtoria e Urbanizmit | Gjatë vitit | Gjatë vitit | |
| 14 | Ngritja e nivelit komunal e gatishmërisë emergjente. | Plani i punës | DMSH | Policia, FSK, subjektet komunale, OJQ, etj. | Sipas nevojës | Gjatë vitit | |
| 15 | Kontaktet permanente në relacionin DMSH me qendrën regjionale për koordinim emergjent. | Plani i punës | DMSH | QRKE-Mitrovicë, si dhe AME Prishtinë | Gjatë vitit | Gjatë vitit | |
| 16 | Bëhet planifikimi, evidentimi dhe sistemimi i resurseve njerëzore dhe mjeteve materialo-teknike për nevoja emergjente. | Plani i punës | DMSH | NJPZSH, zyra e Kryqit të Kuq | Gjatë vitit | Gjatë vitit | |
| 17 | Zyra e alarmit dhe koordinimit emergjent (ZAKE), informimi i publikut për rreziqet e mundshme dhe dhënien e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. | Plani i punës, Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera | DMSH | Qendrat e BL ku janë të vendosura radiolidhjet, (japin informata drejt nga terreni), Kryqi i Kuq | Gjatë tërë vitit | Gjatë tërë vitit | |
| 18 | Pranimi, evidentimi dhe distribuimi i informatave | Plani i punës, Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera | DMSH | Subjektet relevante kompetente | Gjatë vitit | Gjatë vitit | |
| 19 | Planifikimi dhe pajisja me mjete materialo-teknike | Plani i punës | DMSH | Bordi i drejtorëve | Janar | Qershor | |

**Kulturë, rini dhe sport**

Më poshtë do të gjeni tabelën me aktivitete përgjatë vitit 2017

| Nr. | Drejtoria | Shënimi i datave dhe aktiviteteve | Aktivitetet | Periudha kohore | Pjesëmarrësit tjerë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | / | Vazhdimi i kampanjës për mbledhjen e "Ne dhurojmë libra" libra në bibliotekën e qytetit | Janar – dhjetor 2017 | • Biblioteka "Naim Frashëri"<br>• Qytetarët |
| 2. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | / | Do të vazhdohet me shpërndarjen e librave që janë në numër të madh të ekzemplarëve nga biblioteka amë në ato të terrenit. | Janar – dhjetor 2017 | • Biblioteka "Naim Frashëri"<br>• |
| 3. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | / | Përmes bibliotekës, DKRS do të organizojë promovime të ndryshme të librave, qoftë të krijuesve shkencorë, qoftë të atyre të rinj. | Janar – dhjetor 2017 | • Biblioteka "Naim Frashëri"<br>• |
| 4. | DKRS | / | • Digjatilizimi i bibliotekës | Mars-qershor | • Biblioteka "Naim Frashëri" |
| 5. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | / | Vazhdimi i punës në hulumtimin e kulturës shpirtërore si: Ceremonitë, prozën (tregimet, etj.), poezinë (këngët epike lirike), legjendat, lojërat popullore, ritet e lindjes, ritet e martesës, ritet e vdekjes, ninullat, këngët e dasmave, këngët historike, vajtimet, etj. | Janar – dhjetor 2017 | • Muzeu i qytetit<br>• Qytetarët |
| 6. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë | / | • Pranim – dorëzimi i lëndëve arkivore (vitet 1985) | Janar - dhjetor | Arkivi i qytetit, Gjykata komunale, Komisioni arkiv- |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | dhe Sportit | | | | gjykatë |
| 7. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | | Risistemimi përfundimtar i dokumentacionit i cili është sistemuar para vitit 1999 | Janar – dhjetor 2017 | • Arkivi i qytetit<br>• Depo e arkivit<br>• Stafi i arkivit |
| 8. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | | Pranim – dorëzimi i materialit të komunës | Janar – dhjetor 2017 | • Arkivi i qytetit - komunë<br>• Arkiv komisioni i përbashkët. |
| 9. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 17 Shkurt-manifestim i ''Ditës së Pavarësisë'' | Homazhe, program artistik, hapja e ekspozitës me piktura, marshi i pavarësisë, program artistik për të rinj, orë letrare, turne i hapur në pingpong dhe sporte tjera | 17 shkurt 2017 | Institucionet, shoqatat e dala nga lufta, ansambli Hasan Prishtina, biblioteka "Naim Frashëri", organizatat rinore, klubi pingpong "H.Prishtina'' |
| 10. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Shfaqje për fëmijë "Babë e djalë palaço" | Ka karakter edukativ - Do të reprizohet disa herë për të parë të gjitha shkollat | Mars-qershor | • Teatri i qytetit |
| 11. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 5 dhe 6 Mars Epopeja e UÇK-së | • Homazhe<br>• Program artistik<br>• Gara në pikturë<br>• Gara sportive shkollore | 5-6 mars | Institucionet, shoqatat e dala nga lufta, ansambli "Hasan Prishtina", shkollat e mesme të ulëta SHPKF SSH |
| 12. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Dita e Gruas | • Program artistik<br>• Orë letrare me poetet femra<br>• Ndeshje hendbolli, volejbolli në konkurencën e femrave | 8 mars | Institucionet, ansambli "H. Prishtina", biblioteka "Naim Frashëri", klubet sportive të femrave |
| 13. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | / | Do të organizohen fushata nëpër shkolla, për zbulimin e librit të rrallë | mars-qershor | • Biblioteka "Naim Frashëri" |
| 14. | DKRS | ''Dita botërore e ujit'' | • Kampanjë për ruajtjen e ujit | 22 mars | • Organizatat rinore |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 15. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Dit Bibliotekës" | Organizim me anëtarët e bibliotekës Orë letrare me lexues, gara e recitatorëve | 24 mars | Institucionet, biblioteka "Naim Frashëri" |
| 16. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Premierë - komedia "Mblesëria" | • Shfaqja premierë dhe reprizimi | Prill - dhjetor | • Teatri i qytetit |
| 17. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Fushatë për mbledhjen e eksponateve | Mbledhja e sa më shumë eksponateve nga fusha e historisë, arkeologjisë dhe etnografisë. | Prill-qershor | • Muzeu i qytetit<br>• Shkollat fillore dhe të mesme |
| 18. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Dita botërore e shëndetit" | • Kampanjë vetëdijësuese për shëndet më të mirë | 7 prill | Drejtoria e Shëndetësisë, organizatat rinore, shkollat e mesme të ulëta dhe të larta |
| 19. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Dita ndërk.e e çlirimit të të burgosurve' | • Tryezë e rrumbullakët me historianë dhe të përvuajtur nëpër burgje | 11 rill | Historianët, Shoqata e të burgosurve politik, organizatat joqeveritare |
| 20. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Shënimi i "Ditës ndërk. të monumente-ve të kulturës" | • Vizitë monumenteve të kulturës në qytet dhe rrethinë | 18 prill | • Muzeu i qytetit |
| 21. | DKRS | "Dita e tokës" | • Gara me piktorë të rinj | 22 prill | • Organizatat rinore |
| 22. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Dita ndërkombë - tare e librit" | • Kampanjë vetëdijësuese nëpër shkolla | 23 prill | Biblioteka "Naim Frashëri", organizatat rinore, shkollat fillore dhe të mesme |
| 23. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Zëri më i mirë- Vushtrria 2017 | Selektimi i të rinjve me aftësi këndimi, ushtrimi me ta, organizimi i finales dhe shpallja e fituesve | 25 prill- 9 maj | • Ainansambli i këngëve dhe valles "Hasan Prishtina" |
| 24. | DKRS | / | Oraganizimi i aktiviteteve për ripërtëritjen e traditave. | maj | • Muzeu i qytetit<br>• Qytetarët |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 25. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Promovimi i bukurive natyrore të qytetit | • Koncert muzikor<br>• Zhvillimi i aktivitetit në ndonjërën nga bukuritë natyrore që ka Vushtrria | 1 maj | • Organizatat rinore |
| 26. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 2 Maji Studimja 99 | • Akademi përkujtimore<br>• Turne në shah | 2 maj | Ansambli "Hasan Prishtina" Klubi i shahut "Llamkos" |
| 27. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Dita e Evropës" | • Turne në futboll të vogël<br>• Gara në ese<br>• Gara në pikturë | 9 maj | Zyra për integrime evropiane, shkollat e mesme të ulëta dhe të larta |
| 28. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Dita e Muzeut" | Organizimi i disa kinove muzeale në "Kalanë e Vjetër" për nxënës, me qëllim të promovimit të kulturës shpirtërore | 10 maj | • Muzeu i qytetit<br>• Nxënësit e shkollave<br>• Qytetarët |
| 29. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 22 Maji | • Homazhe<br>• Akademi përkujtimore | 22 maj | Institucionet Shoqatat e dala nga lufta Ansambli Hasan Prishtina |
| 30. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Aksioni ta pastrojmë Kosoven | • Pastrimi i shkollave, rrugëve, objekteve të ndryshme | 23 maj | Organizatat rinore, shkollat fillore dhe të mesme |
| 31. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Dita botërore kundër duhanit" | • Kampanja vetëdijësuese me të rinj<br>• Gara në pikturë | 31 maj | Organizatat rinore |
| 32. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Dramë për gjenerata më të vjetra të teatrit | Teatri i qytetit - Do të diskutohet se cila do të jetë tematika e dramës: "Skënderbeu" apo "Unë nuk e solla Doruntinën" - "Ali Pashë Tepelena" | Qershor-dhjetor | Teatri i qytetit të Vushtrrisë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 33. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Dita ndërkombë-tare e fëmijëve" | Festivali për fëmijë, turne në basket grupmoshat e reja, gara në pikturë me fëmijë në shesh, karnavali me personazhet e filmave vizatimorë. | 1 qershor | Ansambli "H. Prishtina", shkolla e muzikës "Tefta Tashko, klubi i basketit "Vushtrria Basket", shkollat fillore, teatri i qytetit |
| 34. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Dita e çlirimit të Vushtrrisë" | Homazhe, parakalim përgjatë sheshit program kulturo-artistik, hapja e ekspozitës, orë letrare, gara sportive shkollore, mbrëmje rinore me të rinj | 17 qershor | Institucionet, shoqatat e dala nga lufta, ansambli ''Hasan Prishtina'', biblioteka "Naim Frashëri", organizatat rinore SHPKF SSH |
| 35. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Takimet e Poeteshave" | Hapja e konkursit, përzgjedhja e poezive, pritja e poeteshave, vizitë objekteve të trashëgimisë kulturore, ora e madhe letrare, shpallja e fituesve | qershor | Institucionet, ansambli ''H. Prishtina'', Muzeu Historik Etnografik i qytetit, biblioteka "Naim Frashëri", poetet, juria |
| 36. | DR | ''Dita kundër narkotikëve'' | • Kampanja vetëdijësuese me rini | 26 qershor | • Organizata rinore |
| 37. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Panairi i artizanateve | Organizimi i panairit artizanal-etnokulturor në nivel regjional gjatë muajit të diasporës, ku do të ekspozohen artizanate nga mjeshtërit apo artizanët. | korrik | • Muzeu i qytetit<br>• Artizanët |
| 38. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | "Ditët e Diasporës" | Program kulturo-artistik, orë letrare, vizitë bukurive natyrore të Vushtrrisë, aktivitete rinore | korrik | Ansambli ''Hasan Prishtina'' Muzeu Historik Etnografik i qytetit, biblioteka "Naim Frashëri", organizatat rinore |
| 39. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Muaji i pikturës | • Organizimi i muajit të pikturës me artistët e rinj | | Sektori i rinisë, organizatat rinore, OJQ-të, "Kult Studio", artistët |
| 40. | DKRS | „Dita ndërk.e e Rinisë" | Koncert me rini, kinema verore, ekspozitë pikturash | 12 gusht | • Organizatat rinore |
| 41. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | / | Inspektimi i regjistraturave jashtë arkivit | shtator - tetor 2017 | Arkivi i qytetit, shkollat fillore e të mesme, si dhe të gjitha organizatat lokale – komisioni i arkivit |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 42. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 1 Shtatori- „Dita e Dëshmorëve të Kombit'' | Homazhe, akademi përkujtimore, hapja e ekspozitës me fotografi, turneu tradicional në hendboll "Jeton Tërstena-TOTA" | 1 shtator | Institucionet, shoqatat e dala nga lufta, ansambli „Hasan Prishtina'', organizatat rinore, klubi i hendbollit "Kosova " |
| 43. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | ''Dita botërore pa makina'' | • Kampanjë për ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimit të biçikletave | 22 shtator | • Organizatat rinore |
| 44. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Premiera e shfaqjes për fëmijë " Pinokio " | • Premiera e shfaqjes për fëmijë " Pinokio " | tetor | • Teatri i qytetit të Vushtrrisë |
| 45. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | „28 Nëntori Dita e Flamurit'' | • Homazhe<br>• Program kulturo-artistik<br>• Ekspozitë kushtuar 28 Nëntorit<br>• Garë në piktura<br>• Garë në ese<br>• Aktivitete sportive basketboll, hendboll, futboll, pingpong | 28 nëntor | Institucionet, shoqatat e dala nga lufta, ansambli „Hasan Prishtina'' Muzeu Etnografik Historik, organizatat rinore<br>• *KBB " Vush.Basket<br>• *KPP "Hasan Prishtina"<br>• SHPKF SSH |
| 46. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 3 Dhjetor- „Dita ndërk. ePersonave me aftësi të kufizuara'' | • Turniri i futbollit<br>• Organizimi i një vizite i trashëgimisë kulturore | 3 dhjetor | • Shoqata e të Shurdhërve-dega Vushtrri<br>• Muzeu Etnografik Historik |
| 47. | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Shpallja e sportisitit të vitit 2017 | • Organizim ku do të shpallet sportisti i vitit | 24 dhjetor | • Sportistët nga Komuna e Vushtrrisë |

Duke qenë i vetëdijshëm se brenda vitit 2017 mund të ketë ndryshime apo zhvillime dhe po ashtu edhe aktivitete tjera, ky plan si i tillë mund të evoluojë, përkatësisht ndryshojë apo plotësohet. Sidoqoftë, i njëjti reflekton prioritetet, objektivat dhe aktivitetet e planifikuara gjatë vitit 2017. Mirëpres sugjerimet, të cilat do të mund të inkorporohen në tekstin e këtij plani apo bashkëngjiten në shtojcë.

Kryetari i Komunës
Bajram Mulaku